



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 09.06.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 9,10 dhe 13.1 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe Përfundimit nr. 06-35073-17/2 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt: 22.05.2015, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e cila është e ndërlidhur me kërkesën e Shoqatës “Bell Arte Kosova”, për mbështetje financiare të kësaj shoqate për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të Festivalit Ndërkombëtar “Pianisti i Ri 2015”, me dt: 09.06.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, e cila është e ndërlidhur me kërkesën e Shoqatës “Bell Arte Kosova”, e evidentuar me nr. 01-400-35025 e dt: 21.05.2015, për mbështetje financiare të kësaj shoqate për mbulimin e një pjese të shpenzimeve të organizimit të Festivalit Ndërkombëtar “Pianisti i Ri 2015”, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 1.000€ .

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të zotoj mjetet financiare në vlerë prej 1.000€, nga pozicioni i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë Shoqatës “Bell Arte Kosova” nr. 1501090000161190, Raiffeisen Bank .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Znj. Vlora Baruti, drejtoreshë e Festivalit “Pianisti i Ri 2015”
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila